

Konferencë Shkencore:

"Kushtetuta si instrument Qëndrueshmërie dhe Zhvillimi"

Fjala e Z. Ettore Sequi, Ambasador i Bashkimit Europian në Shqipëri

I nderuar Kryetar i Gjykatës Kushtetuese, Z. Bashkim Dedja,

I nderuar President Nishani,

I nderuar Kryetar i Kuvendit Meta,

I nderuar Kryeministër Rama,

Të ftuar të shquar,

Është kënaqësi të jem këtu sot me të gjithë ju për të festuar këtë përvjetor të rëndësishëm – 15 vjetorin e Kushtetutës. Pra, për të festuar 15 vjetorin e themeleve të shtetit modern shqiptar.

Këto themele u konceptuan nga disa prej mendjeve më të mençura të kësaj shoqërie dhe u miratuan nëpërmjet referendumit nga sovrani, pra nga populli shqiptar. Këto themele u konceptuan dhe miratuan me konsensus të gjerë politik dhe shoqëror, por ato mbrohen para së gjithash nga Gjykata Kushtetuese.

Jam i sigurt se shumë prej jush e njohin historinë e Kullës së Pizës. E mendoj atë si një metaforë të përshtatshme për Kushtetutën. Themelet e Kullës së Pizës shtrihen mbi një terren të paqëndrueshëm dhe mbajnë sipër tyre një strukturë të bukur të ndërtuar në shekuj, që prej shekullit të 12-të. Puna e shumë arkitektëve dhe inxhinierëve gjatë shekujve e ka mbajtur Kullën të qëndrueshme, ndonëse mbetet e anuar. Në të vërtetë ajo nuk është perfekte, por është funksionale.

Kushtetuta ngjan me themelet solide në një terren të lëvizshëm – terrenin e shoqërive. Sa kohë që ato janë dinamike, energjike, të mbushura me ambicie dhe konkurrencë, të privuara nga një autoritet i përbashkët që do t'i mbronte ndaj abuzimeve dhe arbitraritetit – shoqëritë janë si terreni, dinamike dhe ndonjëherë edhe të paparashikueshme.

Kushtetuta e prezanton veten në mënyrë të qëndrueshme në një shoqëri, për të ngritur më pas një shtet që do të siguronte stabilitet, parashikueshmëri, besueshmëri – duke ditur se terreni do t'i shpëtonte prirjes për të qenë i rrëshqitshëm, pasi ky terren është shtëpia e gjithë veprimtarisë politike, ekonomike dhe shoqërore.

Si në rastin e Kullës së Pizës, ku terreni dinamik që ndodhet poshtë saj ka kërcënuar herë pas here qëndrueshmërinë e Kullës, veprimtaria intensive e interesave që përplasen në sferat politike, ekonomike dhe shoqërore ndikon herë pas here në qëndrueshmërinë e strukturave që drejtojnë shoqërinë si një e tërë.

Si në rastin e Kullës së Pizës, ku arkitektët dhe inxhinierët kanë punuar për të ruajtur qëndrueshmërinë e saj gjatë shekujve, është kryesisht përgjegjësia e Gjykatës Kushtetuese të mbrojë rendin kushtetues, në të vërtetë gjatë shekujve.

Në këtë kuptim, Gjykata Kushtetuese ka detyrën e vështirë të tejkalimit të së tashmes, duke mbrojtur të gjithë pyllin dhe jo vetëm pemët. Qëndrueshmëria e kullës, e cila nënkupton shtetin, mbështetet në vendimet kushtetuese që duhet të jenë afatgjata dhe sistemike, vendime që duhet të mbajnë parasysh gjithë strukturën, duke mos ofruar arnime apo zgjidhje afatshkurtra vetëm për të tashmen.

Ndonjëherë veprimtaria e terrenit është e tillë sa bën që themelet të rishihen dhe forcohen, në mënyrë që kulla, e cila nënkupton shtetin, të perfeksionojë qëndrimin, stabilitetin dhe funksionimin e saj. Në këtë kontekst, terreni dinamik, pra presionet nga fushat e veprimtarisë politike, ekonomike dhe shoqërore që janë edhe burim i dinamizmit, janë në të njëjtën kohë edhe burim i zhvillimit të shtetit nëpërmjet forcimit të themeleve të tij.

Në vlerësimin e detajuar të Komisionit European për Shqipërinë në vitin 2010, si përgjigje e aplikimit të vendit për marrjen e statusit të vendit kandidat, thuhet se gjatë viteve të fundit Gjykata Kushtetuese ka mundur ta tregojë veten si një institucion i pavarur. Kjo nënkupton se përgjithësisht Gjykata ka qenë e suksesshme në detyrën e vështirë të tejkalimit të së tashmes, duke mbrojtur të gjithë pyllin.

Riemërimi i kohëve të fundit i Kryetarit Dedja mund të jetë një provë e mirë e përmbushjes së detyrave dhe e qëndrueshmërisë së Gjykatës. Ne shpresojmë që ky riemërim të jetë edhe një shenjë e angazhimit të nevojshëm të të gjithë aktorëve politikë shqiptarë për vazhdimësinë e veprimtarisë së Gjykatës Kushtetuese.

Zonja dhe Zotërinj,

Mbas më shumë se 20 viteve që prej krijimit të saj, ngarkesa e punës së Gjykatës Kushtetuese dhe nevojat e kërkesat e shoqërisë shqiptare kanë ndryshuar. Gjykata po përballet me sfida të reja. Sfida më evidente është ndoshta rritja dramatike e numrit të çështjeve që i adresohen gjykatës, çka kërkon përgjigje ligjore dhe institucionale me qëllim gjetjen e balancës ndërmjet nevojës për efikasitet dhe të drejtës së qytetarëve për mbrojtje kushtetuese.

Ligji organik i Gjykatës mund të përditësohet për të adresuar sfidat me të cilat ajo do të vazhdojë të përballet. Synimi duhet të jetë rritja e efikasitetit dhe përshtatja e normave rregulluese të Gjykatës Kushtetuese me standardet më të mira europiane.

Progres Raporti i Shqipërisë për vitin 2013 shprehet se “duhet ende të miratohet legjislacioni i rëndësishëm për reformën e Gjykatës Kushtetuese.” Drejt kësaj reforme, Bashkimi Europian ka ofruar ndihmë teknike nëpërmjet Projektit të mëparshëm Euralius, i cili ka paraqitur një raport mbi nevojat e reformimit të ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Është e nevojshme që kjo reformë të adresohet së shpejti pranë autoriteteve shqiptare, me shkallën maksimale të konsensusit politik dhe teknik.

Pas vëzhgimeve dhe analizimeve të kujdesshme të funksionimit të institucioneve shtetërore dhe ndarjes së pushteteve në Shqipëri, një rekomandim i veçantë i Progres Raportit ishte se ka ende nevojë për ndërhyrje thelbësore. Në mënyrë më specifike, sistemi aktual i emërimit të gjyqtarëve nga Kuvendi, me shumicë të thjeshtë votash, duhet të reformohet. Qëllimi specifik i kësaj reforme është depolitizimi i plotë i këtyre emërimeve.

Zonja dhe Zotërinj,

Këto janë ndërhyrjet që do ta pengojnë kullën, e cila nënkupton shtetin demokratik, të bjerë pak e nga pak nga terreni dinamik që ndodhet poshtë themeleve të saj.